



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 10.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 09.07.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, **Ambulanca Dhe Farmacia Veterinare Goni, Fsh Bablak, 70000, ferizaj, Kosovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Trajtimi i qenve endacak", me Nr. të Prok: 613-23-4897-2-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **Ambulanca Dhe Farmacia Veterinare Goni, Fsh Bablak, 70000, ferizaj, Kosovë** të dt. 09.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Trajtimi i qenve endacak", me nr. të Prok: 613-23-4897-2-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për **Grup i Operatorëve Ekonomik AMBULANTA VETERINARE PASSION PET SH.P.K.; FAREDIN MUJAJ B.I., Lipjan, Rr Haradin Bajrami, 14000, Lipjan, Kosovë**. Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 06.07.2023

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Ambulanca Dhe Farmacia Veterinare Goni, Fsh Bablak, 70000, ferizaj, Kosovë**, me datë 09.07.2023 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Trajtimi i qenve endacak", me nr. të Prok: 613-23-4897-2-2-1 ku këtë aktivitet AK ka shpallur fitues **Grup i Operatorëve Ekonomik AMBULANTA VETERINARE PASSION PET SH.P.K.; FAREDIN MUJAJ B.I., Lipjan, Rr Haradin Bajrami, 14000, Lipjan, Kosovë**, për shpërblim me kontratë të datës 06.07.2023 dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik **Ambulanca Dhe Farmacia Veterinare Goni, Fsh Bablak, 70000, ferizaj, Kosovë**, me datë 09.07.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Trajtimi i qenve endacak", Autoriteti Kontraktues, me datë 10.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Sa i përket pretendimit tuaj të parë në lidhje me stafin profesional ne baze të kërkesave të AK-se, OE i rekomanduar për kontratë i plotëson këtë kërkesë për arsye se si data për pervojën e punës për këtë staf kërkohej data e diplomimit duke e deshmuar me CV, e jo data e nënshkrimit të kontratës për marrëdhënie pune ndërmjet OE dhe të punësuarit. Ky pretendim është i pabazuar
2. Pretendimi juaj i dytë ka të bëjë me anëtarin e konzorciumit Faredin Mujaj B.I, ku ne baze të kërkesave të AK-se ky anëtar është i obliguar të prezentojë Licencën e AUV e jo edhe Diplomen dhe CV-ne. Ky pretendim është i pabazuar
3. Pretendimi juaj i tretë sa i përket listës së paisjeve të listuara në kolonën D, OE e ka plotësuar këtë kolonë me të gjitha të dhënat, ndërsa sipas kërkesave të AK-se nuk ka qenë askund e cekur që OE duhet të nënshkruajë dhe ta vulosë këtë kolonë. Ky pretendim është i pabazuar
4. Pretendimi juaj i katërt sa i përket deklaratës nën betim nuk qëndron për arsye se, sa i përket aktivitetit dhe numrit të prokurimit, platforma elektronike e-prokurimi në dosjen e tenderit nuk e gjeneron titullin dhe numrin e prokurimit, ndërsa OE e ka plotësuar këtë deklaratë me të gjitha të dhënat të cilat figurojnë në dosje të tenderit.
5. Pretendimi ankimor nr 5. Ne baze të kërkesave të AK-se dhe legjislacionit të fuqitë të LPP-se askund nuk ceket se OE duhet të nënshkrujë dhe vulosin specifikacionin teknik të Dosjes së Tenderit. Ky pretendim është i pabazuar
6. Pretendimi i juaj i gjashtë sa i përket listës së paisjeve nuk qëndron për arsye se OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar Aneksin 6 të FDT-se të deshmuar me librezat e qarkullimit i cili në librezë figuron paisja Furgon me 4 dyer i cili është i njëjti me veturën Pikap. Ju rikujtojmë se edhe ju ne oferten tuaj të deshmuar me librezë ju figuron paisja Furgon me 4 dyer e jo Pikap. Ndërsa sa i përket marrëveshjes për shfrytëzimin e makinerisë, ju informojmë se ne baze të deshmisë së ARBK-se Esat Bresa është pronar i kompanisë Passion Pet shpk.
7. Pretendimi i ankimor nr 7. Ne baze të vlerësimit të ofertave nga ana e komisionit të vlerësimit, AK konsideron se Grup i OE "Ambulanca Veterinare Drenas & Ambulanca Veterinare Era" i plotëson kriteret e FDT-se si i pasukseshëm.
8. Pretendimi i ankimor nr 8. Ne baze të vlerësimit të ofertave nga ana e komisionit të vlerësimit, AK konsideron se Grup i OE "Kushtrim Rexhepi B.I" & "Ambulanca Veterinare Veterina" ka referencë të ngjashme për shërbime të tilla.


AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit